



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e XI-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në
Vushtri, mbajtur më 24.11.2011

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:15**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Krustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Mungoi: Ferit Idrizi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Qazim Azemi, anëtar i moshuar i kuvendit, në mungesë të kryesuesit të kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi rendin e ditës ashtu siç është në ftesë, duke propozuar në “të ndryshme” propozim-vendimin që kushtëzon qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për kryerjen e borxheve nga KRM “Uniteti”.

Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike- tha se është hera e dytë që procedohet për mbledhje të kuvendit propozim-vendimi në fjalë, dhe arsyeja pse është paraqitur për herë të dytë në kuvend është se Kuvendi i Komunës së Skenderajt dhe Mitrovicës e kanë aprovuar vendimin në fjalë, prandaj është e nevojshme që edhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ta aprovojë një vendim të tillë, në mënyrë që të kemi një qytet më të pastër, dhe njoftoi se edhe Komuna e Vushtrrisë është aksionare në këtë kompani, sikurse janë edhe dy komunat e lartcekura, prandaj është kërkuar që të tri komunat të aprovojnë të njëjtin vendim për të pasur një qytet më të pastër, dhe pasi që kompania “Uniteti” me teknologjinë aktuale nuk po mundet t’i kryejë shërbimet as 20 % në territorin e Komunës së

Vushtrrisë, kurse kërkesat janë rritur mbi 50 %, duke përfshirë edhe fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, prandaj për ta përmirësuar këtë gjendje, duhet gjithsesi të bëhen pagesat nga qytetarët, dhe për këto arsye ftoi anëtarët e kuvendit që ta aprovojnë vendimin në fjalë, në mënyrë që të zbutet situata financiare në kompaninë në fjalë, dhe njëkohësisht çdo qytetar që paguan, do të kërkojë llogaridhënie.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së përkrah rendin e ditës, përfshirë edhe propozim-vendimin në “të ndryshme”.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së shprehu vërejtje se rendi i ditës është i varfër, kurse seanca e kaluar ka qenë e stërngarkuar, kurse sot edhe pse është agjenda e varfër, në minutat e fundit vjen propozim-vendim për këtë seancë, edhe pse i njëjti nuk është i natyrës urgjente, prandaj për këtë shprehu protestën në emër të grupit në fjalë, duke shtuar se ky është një tregues që mbledhjet e kuvendit nuk po përgatiten mirë. Pastaj paraqiti kritikën për mos lajmërimin me kohë nga kryesuesi i kuvendit, lidhur me mungesën e tij në seancën e Kuvendit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- e përkrahu rendin e ditës, dhe shtoi se ka pritur që në këtë seancë do të trajtohen probleme të një natyre më serioze, se sa kjo që është sot. Gjithashtu, tha se ka pritur që të marrë një përgjigje nga Drejtoria për Arsim, pasi që në mbledhjen e kaluar e ka informuar kuvendin se në disa shkolla janë shkelur procedurat e testit të maturës, dhe nxënësit që nuk kanë arritur ta kalojnë testin e maturës, me ndërhyrje nga Ministria e Arsimit, ata që kanë pasur lidhje, janë pranuar edhe me 38 pikë, dhe numri i atyre ka qenë rreth 20 nxënës, prandaj për këtë çështje ka pritur se do të ketë informatë me shkrim nga drejtoria në fjalë, por në fakt kjo informatë mungon. Në vazhdim tha se me intervenimin e tillë nga Ministria e Arsimit, është bërë diskriminim ndaj nxënësve tjerë, prandaj nuk na duhet një shoqëri e tillë kosovare, pasi që shoqëria duhet të ndërtohet mbi të drejtën. Në fund kërkoi sqarime nga drejtori i Drejtorisë për Arsim pse nuk e ka përgatitur informatën për çështjen në fjalë.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- arsyetoi mungesën e kryesuesit të kuvendit, duke njoftuar se kjo vet ka qenë e caktuar që të shkojë në seminar, por në momentet e fundit është vendosur që të shkojë kryesuesi.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me vërejtjen se kjo seancë ka një rend dite të varfër, tha se ndonjëherë natyra e punës imponon edhe numrin e pikave, dhe ka raste kur paraqiten punë më shumë, e ndonjëherë ka më pak, por shtoi se nuk janë pak pika të rendit të ditës, nëse shqyrtohen pesë pika të rendit të ditës që janë të një rëndësie të veçantë. Kurse duke iu referuar S.Kadriut, tha se shqetësimi i ngritur nga ana e tij, ishte i arsyeshëm, duke premtuar se do të kërkojë përgjegjësi nga drejtori i arsimit pse nuk ka paraqitur një informatë të tillë. Ndërsa, lidhur me propozim-vendimin në “të ndryshme”, tha se në seancën e kaluar të kuvendit nuk është nxjerr vendimi për çështjen në fjalë, dhe shtoi se menaxhimi i mbeturinave nuk është në nivelin e duhur, kurse kompania në fjalë nuk ka shumë mjete, dhe qytetarët nuk po i paguajnë obligimet në këtë fushë, dhe gjithashtu nuk është i mirë menaxhimi i higjienës së rrugëve dhe gjelbërimit.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- kërkoi përgjigje me shkrim nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa lidhur me borxhet që figurojnë në listën e anëtarëve të kuvendit, duke shtuar se në rastin e tij është paraqitur borxhi në emër të prindit, kurse në fakt është i ndarë nga prindi dhe nuk banon me të, prandaj kërkoi përgjigje me shkrim, pasi që figurojnë prona me borxhe, e që realisht nuk ekzistojnë ato prona.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se në seancën e kaluar, ka parashtruar një pyetje lidhur me kontestet gjyqësore, në të cilat si palë ka qenë e involvuar komuna dhe epilogun e tyre, dhe ka marrë informatën, por kërkoi që informata në fjalë të plotësohet me dokumente shitesë që i arsyetojnë dhe dëshmojnë vendimet e gjykatës, dhe shtoi se informatën e ka kërkuar në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, dhe është mirë që në raste të tilla t’iu ipet të gjithë anëtarëve të grupit

parlamentar. Pastaj paraqiti vërejtje për dokumentin i cili përmban rekomandimet e KPF-së, duke thënë se për çdo propozim duhet të ipen sqarime të nevojshme.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit (shqyrtimi i dytë).**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).**
- 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e ditës festive “Dita e Patates” (shqyrtimi i dytë).**
- 5. Shqyrtimi i Organogramit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012 (shqyrtimi i parë).**
- 6. Të ndryshme:**
 - a. Shqyrtimi i propozim-vendimit që kushtëzon qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për kryerjen e borxheve nga KRM “Uniteti”;**
 - b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në faqen nr. 3, në diskutimin e tij, kërkoi që fjala “çështja” të korrigjohet dhe të shkruhet “qasja”.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së kuvendit të komunës, me vërejtjen nga R. Ramaj.

2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit (shqyrtimi i dytë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se kuvendi i komunës po formon trupa të kuvendit vetëm formalisht, pasi që për këtë draft-rregullore askund nuk precizohet se ka kaluar përmes Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Pastaj duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje: te neni 1, propozoi që të hiqet fjala “i përballueshëm”; te neni 7, propozoi që pas pikës “a” të shtohet: “t’i nënshtrohet procedurës së marrjen e pëlqimit mjedisor, respektivisht lejes mjedisore”; te neni 11, paragrafi 11.1 duhet të jetë “me planin zhvillimor të komunës dhe planet rregulluese urbane”, ose “me planin hapësinor të komunës, ku përfshihet edhe plani zhvillimor i komunës dhe planet rregulluese urbane”; te neni 13, në fund të fjalisë propozoi të shtohet “si në nenin 7 të kësaj rregulloreje”; te neni 21.3, tha se titulli flet për plan lokal të veprimt, prandaj hartuesi është dashtë ta ketë parasysh që të jetë: “plani lokal i veprimt në mjedis, dhe programet mjedisore, para aprovimit, i dërgohen MMPH-së”; te neni 44.4, propozoi që afati i ankesës të jetë 30 ditë, pasi që me Ligjin e Procedurës Administrative është i përcaktuar ky afat, e jo të jetë 8 ditë, siç është propozuar në draft-rregullore; mandej te “ndëshkimet dhe gjobat” tha se përdoret në shumë raste fjalia “mbeturina komunale”, prandaj nuk duhet të jetë ky formulim, pasi që mbeturinat nuk ndahen në nivel të organizimit komunal. Pastaj aty ku ceket te neni 48 se gjobat e qytetarëve për hedhjen e mbeturinave në kontejner të caktuar, propozoi që t’i shtohet ky pasus: “aty ku janë të vendosur kontejnerët për llojin e hedhjes së mbeturinave në kontejnerë të posaçëm”. Gjithashtu tha se është mirë që hartuesi ta

merr parasysh rregulloren që kuvendi e ka aprovuar më parë, në të cilën janë përcaktuar gjambat rreth mbrojtjes së ambientit dhe të harmonizohen, ose në fund në tekstin e kësaj rregulloreje të ceket se me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, të shfuqizohen nenet e caktuara që kanë qenë në fuqi të rregullores së mëparshme.

Naile Osmani, anëtare e kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se te neni 48.4, propozoi që nga fjalia “automjeti në lëvizje” të hiqet pjesa e fjalisë “në lëvizje”. Pastaj te neni 48.5.2 është një gabim teknik, ku thuhet “pesetat”, e duhet thënë “pusetat”.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje: te neni 3, pika “e” përdoret termi “ligj”, kurse duhet të përdoret termi “rregullore”; te pika “h” thuhet “mbeturina të rrezikshme”, kurse më tutje thuhet “dëmi nga shoqëria”, prandaj kërkoi që të riformulohet fjalia, pasi që është e pakuptimtë; te neni 5.2, duhet me qenë “mbikëqyrjen e aktiviteteve”; te neni 5.6 duhet me qenë “mbajtjen e shënimeve...”; te neni 5.7 duhet me qenë “sigurimin e qasjes së papenguar ...”; te neni 5.9 duhet me qenë “zvogëlimin gradual të ndotjes ...”; te neni 5.12 dhe 5.13 duhet me qenë “mbrojtjen ...”; te neni 7, te pika “b” duhet me qenë “të respektojnë ...” te pika “d” duhet me qenë “të zvogëlojnë”; te pika “e” duhet me qenë “të rehabilitojnë ose rikthejnë ...” te neni 8.2 tha se askund nuk është dhënë sqarimi çfarë domethënie ka shkurtesa MMPH; te neni 25.1 duhet të shënohet edhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se hartuesi nuk i ka specifikuar elementet me sanksione dhe pa sanksione, duke iu referuar asaj që në draft-rregullore thuhet: “hedh mbeturinat medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë; hedh mbeturinat medicinale jashtë kontejnerëve për këto mbeturina”, prandaj tha se së pari duhet të ipet udhëzimi, të respektohet kriteri i ndarjes së mbeturinave mjekësore, dhe ai që nuk i respekton ato kritere, t’i nënshtrohet sanksionit.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- pasi që e mbështeti draft-rregulloren, tha se është skeptik në zbatimin e saj, duke shtuar se ka rregullore shumë të mira në të gjitha nivelet qeveritare, por sa zbatohen, dhe pikërisht rregulloret po shkelen nga ata që i krijojnë. Pastaj tha se në qytetin e Vushtrrisë nëpër lagje të ndryshme ka shtalla, që kundërmojnë dhe të njëjtat e pengojnë rrethin (fqinjët), por edhe i bllokajnë kanalizimet dhe krijojnë probleme të jashtëzakonshme, prandaj kërkoi që përmes kësaj rregulloreje të ndalohet mbajtja e kafshëve në qytet.

Idriz Ismajli, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- njoftoi se draft-rregullorja ka qenë në diskutim publik, gjithashtu kanë pranuar vërejtje edhe përmes postës elektronike. Kurse lidhur me çështjen e ngritur për shtallat, tha se ekziston rregullorja e cila e përcakton saktë distancën e shtallës nga shtëpitë e banimit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me propozimin që të ndalohet mbajtja e shtazëve në qytet, tha se është propozim i mirë, por ndoshta është herët që të merret një vendim i tillë. Pastaj tha se është mirë që në planet rregullative të përcaktohet saktë se ku mund të lejohet dhe ku nuk mund të lejohet ndërtimi i shtallave dhe mbajtja e kafshëve.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se përveç dënimeve të parapara, është mirë që të përfshihet edhe stimulimi (shpërblimi) për ata që mbajnë pastërtinë më të mirë në shkollë, fshat apo lagje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit, duke inkorporuar vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se nuk ka pas fare diskutim publik, pasi që nuk njeh prodhues që ka marrë pjesë në këto diskutime publike dhe që është pajtuar që të mos punohet të dielave, por kjo është një rregullore që i konvenon dikujt. Kurse sa i përket bizneseve që merren me material ndërtimor, dhe pasi që puna e tyre është sezonale, propozoi që këtyre bizneseve t'iu lejohej të punojnë edhe të dielave prej 1 prillit deri më 31 tetor. Gjithashtu shtoi se në mesin e bizneseve që kanë kërkuar që të punojnë të dielave, janë disa biznese që nuk e kanë të shlyer taksën komunale, dhe njëri prej bizneseve ka borxh 2.300 € taksë komunale.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se më herët kuvend i komunës e ka aprovuar një rregullore e cila përcakton orarin e punës për biznese, por pasi që disa biznese kanë kërkuar që të lejohen për të punuar të dielave, kërkoj që të lejohen të punojnë edhe të dielave, por të mos lejohen të punojnë në rastet kur të dielave mund të jetë ndonjë festë kombëtare dhe shtetërore, sidomos të lejohen kompanitë ndërtimore dhe ushqimore, por inspekcioni duhet të jetë i kujdesshëm që këto kompani të mos i shfrytëzojnë punëtorët edhe të dielave, duke mos iu dhënë asnjë ditë pushim javor, prandaj të kompensohet dita e diel, me një ditë tjetër pushimi.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së e mbështet propozim-vendimin në fjalë, por me kusht që të zbatohet Ligji i Punës, dhe kërkoj nga organet komunale që të mbikëqyrin të gjitha bizneset, pasi që në mënyrë mizore i shfrytëzojnë punëtorët.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë, dhe kërkoj nga organet kompetente që të përcillet puna e punëtorëve nëpër këto kompani.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 7.2 i Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë Nr.272/10, dt.30.12.2010, teksti i të cilit riformulohet si vijon:

“Ditëve të vikendit (të dielave) depot nuk punojnë, përveç depove të materialit ndërtimor ”.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e ditës festive “Dita e Patates” (shqyrtimi i dytë).

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim- tha se drejtoria në fjalë ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore për të informuar qytetarët për diskutim publik lidhur me propozim-vendimin në fjalë dhe njoftoi për ecurinë e diskutimit publik.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim përcaktohet ditë festive “Dita e Patates” në Komunën e Vushtrrisë, në mes të periudhës kohore nga dita 1 deri 10 e muajit tetor e çdo viti kalendarik.

5. Shqyrtimi i Organogramit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012 (shqyrtimi i parë).

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se propozimi në fjalë është trajtuar edhe në KPF. Pastaj njoftoi se së bashku me USAID-in jemi duke punuar për ndryshime dhe plotësime në administratën e komunës, dhe shtoi se ka mendime që vitin e ardhshëm përsëri të inicohet ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dhe gjithashtu të nxirret një rregullore për ndryshime dhe plotësime në administratën komunale. Kurse lidhur me organogramin në fjalë, tha se në hartimin e këtij organogrami iu ka ndihmuar edhe USAID-i, dhe njoftoi se nuk do të ketë nevojë për rritjen e numrit të punëtorëve në administratën komunale.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin, tha se është mirë që në nenin 1, t'i shtohet edhe fjalia: "i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi". Kurse neni 3 të bëhet neni 4, dhe të shtohet një nen me këtë përmbajtje: "me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i mëparshëm për organogramin e Komunës së Vushtrrisë". Pastaj tha se ka bërë krahasimin në mes të skemës aktuale të komunës dhe propozimit për skemën e re, dhe nga kjo shihet se ka shtim për tre sektorë, janë propozuar 2 sekretari, pastaj ka shkelje të nenit 7 të Ligjit për Shërbimin Civil, i cili thotë se "çdo institucion që punëson nëpunës civil, ka një njësi për menaxhimin dhe zhvillimin e personelit dhe burimeve njerëzore", kurse në organogram është vetëm udhëheqësi i personelit. Mandej pyeti pse është hequr mbrojtja e shëndetit publik në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe ku ka hyrë ky sektor? Në vazhdim duke iu referuar sektorit të ri "menaxhimi i pronës së komunës", pyeti se a është fjala për zyrtar që bën identifikimin dhe evidentimin në bazë të ligjit të pasurisë komunale, apo është fjala për menaxhim të pronës? Në fund tha se shtimi i sektorëve të rinj do të ketë kosto financiare, pasi që kur të shtohen sektorët, caktohen udhëheqësit e sektorëve, dhe do të ketë ngritje të pagave.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar organogramit, tha se te Drejtoria për Buxhet është sektori "menaxhimi i pronës së komunës", kurse te Drejtoria për Kadastër dhe Pronë është sektori "kadastër dhe pronë", prandaj ky është një gabim, dhe shtoi se është një gabim te Drejtoria për Buxhet, pasi që nuk duhet të jetë emërtimi "menaxhimi i pronës së komunës", por te Drejtoria për Buxhet duhet të jetë "menaxhimi i asetëve fikse", kurse në Drejtorinë për Kadastër duhet të mbetet ashtu siç është paraqitur në propozim-organogramin, sepse në këtë sektor, në grupin e pronës bëjnë pjesë edhe paratë që janë në llogari bankare të komunës, llogaritë e arkëtueshme, stoqet dhe parapagimet.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- duke iu referuar organogramit, paraqiti vërejtje tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe shtoi se në skemën organizative paraprake kanë qenë tri sektorë, kurse arkivi nuk mund të jetë sektor, pasi që në kuadër të drejtorisë në fjalë ekziston muzeu dhe biblioteka, që janë të nivelit të njëjtë, prandaj arkivi duhet të vendoset në sektorin e kulturës si institucion më i ultë se sa sektori.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- pasi që përkrahu organogramin në fjalë, kërkoi sqarime për këto çështje, tha se nuk dihet se a paguhen Komiteti për Komunitete, Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, Këshilli për Siguri në Bashkësi, dhe katër komitetet konsultative kujt i raportojnë, pasi që në kuvend asnjëherë nuk kanë raportuar, dhe shtoi se me përjashtim të dy komiteteve, të tjerat komitete vetëm figurojnë në organogram, prandaj nëse nuk japin kontributin për çka janë themeluar, dhe është mirë që fare mos të figurojnë në organogram. Pastaj tha se nëse ndryshohet organogrami, është mirë të mendohet edhe për Drejtorinë për Bujqësi, duke njoftuar se tash ka kaluar në përgjegjësi të komunave edhe ruajtja, mbikëqyrja dhe mbarështimi i pyjeve, gjithashtu themelimi i Drejtorisë për Bujqësi do të

mundësonte absorbimin nga donacioni i Bashkimit Evropian për zhvillimin e sistemit agrar.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- njoftoi se edhe në KPF ka propozuar që në Drejtorinë për Administratë të shtohet Sektori për Diasporën, pasi që dihet rëndësia e diasporës për zhvillimin ekonomik të komunës dhe të Kosovës, dhe remitencat nga diaspora janë 500 milionë euro në vit në nivel të Republikës së Kosovës, kurse në nivel të komunës sillen rreth 8 – 10 milionë euro në vit, prandaj ka rëndësi të veçantë që të shtohet sektori në fjalë.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se që në fillim të mandatit, ka paraqitur vërejtje për fryrjen e numrit të drejtorive. Kurse duke iu referuar Drejtorisë për Arsim, tha se në këtë drejtori punojnë 7 zyrtarë, ndër ta është edhe zyrtari i personelit, i cili punon me listë të pagave në shkollën e mesme teknike dhe është pa konkurs. Mandej tha se në Drejtorinë për Arsim në Mitrovicë punojnë vetëm dy zyrtarë, prandaj kjo tregon se në Drejtorinë e Arsimit në Vushtrri ka fryrje të vendeve të punës, dhe shtoi se punën e zyrtarit të arsimit parashkollor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë mund ta bëjë vetëm një zyrtar, sepse kontrolli nëpër shkolla po organizohet nga MASHT-i, përmes inspektorëve rajonal të udhëhequr nga MASHT-i. Gjithashtu sugjeroi që të ketë racionalitet në funksionalizimin e organogramit, pasi që janë dhënë shumë deklarime për zero tolerancë, për qeverisje të mirë në të gjitha nivelet qeverisëse, kurse është bërë numër i madh i drejtorive, zv.kryeministrave, ministrave, zv.ministrave dhe këshilltarëve, dhe në këtë mënyrë po shpenzohen dhe keqpërdoren shumë të holla të qytetarëve tanë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar organogramit në fjalë, tha se lidhur me Zyrën e Udhëheqësit të Personelit, që sipas ligjit do të duhej të ishte Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe shtoi se fatkeqësisht nuk i kushtohet rëndësi e nevojshme njësisë së burimeve njerëzore, pasi që shumë pak i kushtohet rëndësi çështjeve përmbajtësore, që kanë të bëjnë me vlerësimin në punë, me sistemimin, me menaxhimin e kapaciteteve njerëzore të brendshme, procedurat e avancimit, promovimit në pozicione të caktuara, dhe për këtë arsye ka vendosje jo të mbështetur mirë në profesionalizëm të zyrtarëve, duke shtuar se shumë zyra e kanë këtë mangësi. Në vazhdim i sugjeroi kryetarit të komunës që t'ia jep rëndësinë e nevojshme që duhet ta ketë Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe kryetari i komunës duhet të marrë këshilla nga njësia në fjalë, dhe kjo njësi duhet të jetë e përbërë nga një staf i përgatitur dhe profesional, të cilit nuk i ndërhyhet në punë. Në fund duke iu referuar rekomandimeve që kanë ardhur nga KPF-ja, tha se duhet arsyetuar në kuvend dhe nëse janë me interes, të miratohen nga kuvendi.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së tha se rekomandimet që ka bërë KPF-ja janë të qëlluara dhe duhet të aprovohen. Pastaj duke iu referuar organogramit, propozoi që Komiteti për Auditim të kalojë në anën e kuvendit, e jo të mbetet tek ekzekutivi. Gjithashtu janë të qëlluara propozimet për Zyrë për të Drejtat e Njeriut dhe për Zyrën për Diasporën, dhe shtoi se këto zyra duhet vendosur tek ekzekutivi.

Idriz Muzaqi, drejtor i Drejtorisë për Administratë- duke iu referuar vërejtjeve dhe propozimeve të anëtarëve të kuvendit, tha se Zyra për të Drejtat e Njeriut ekziston në organogramin e komunës, dhe si e tillë parashihet nga MAPL-ja, kurse lidhur me Zyrën për Diasporën, tha se është çështje që mund të diskutohet, dhe shtoi se rreth 30 % të qytetarëve të komunës tonë janë në botën e jashtme, por ende nuk dihet se kush janë dhe ku janë, por nëse mendohet formimi i zyrës në fjalë, për ofrim të shërbimeve për diasporën, tha se është e pamundur që të ketë shërbime të veçanta për ta, pasi që shërbimet komunale janë të njëjta për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Kurse lidhur me kërkesën që duhet të jetë Njësia për Burime Njerëzore, e jo Udhëheqës i Personelit, tha se këtë emërtim e ka përcaktuar LVL-ja. Ndërsa lidhur me vërejtjen për numrin e madh të drejtorive, tha se ky numër i drejtorive është i paraparë me Statutin e Komunës së Vushtrrisë, dhe organogrami

është hartuar konform statutit në fjalë. Ndërsa, lidhur me Komitetin për Auditim, tha se këtë komitet e themelon kryetari i komunës dhe për këtë arsye është i vendosur në organogram të kryetari i komunës. Gjithashtu, tha se me organogram nuk mund të themelohen drejtori të reja. Në vazhdim tha se dy komitetet (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) janë obligative, të parapara me ligj si të tilla, kurse Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim është i paraparë me ligj të veçantë, dhe mbanë takime varësisht prej situatës emergjente, ndërsa lidhur me Këshillin për Siguri në Bashkësi, tha se ky këshill mbanë mbledhje të rregullta një herë në muaj, dhe e kryeson kryetari i komunës. Lidhur me vërejtjen për emërtimin e sektorit të Menaxhimit të pronës të komunës në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, tha se me Udhëzimin Administrativ të MEF-it emërohet Udhëzimi Administrativ për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare, prandaj konform këtij udhëzimi duhet të jetë emërtimi Menaxhimi i Pasurisë së Komunës. Mandej tha se sektori Menaxhimi i Pronës së Komunës që është propozuar në kuadër të DBF-së, dallon nga sektori Menaxhimi i Pronës në Kadastër, pasi që merret me një veprimtari tjetër. Pastaj tha se sektori Shëndetësia përfshin shëndetësinë primare dhe publike. Në fund tha se me Statutin e Komunës së Vushtrrisë janë paraparë të jenë dy sekretari, njëra kryen shërbimet e ekzekutivitet, kurse tjetra sekretari kryen shërbimet e legjislativitet.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar çështjes së ekzistimit të dy sekretarive, tha se LVL-ja e ka paraparë ekzistimin e sekretarive në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se LVL-ja e parasheh Udhëheqësin e Personelit, por nuk bjen fare ndesh me Ligjin mbi Shërbimin Civil, sepse udhëheqës i asaj njësie duhet të jetë Udhëheqësi i Personelit, kurse njësia si njësi është obligim sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 33 vota “për”, 1 “kundër” vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për Organogramin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 25.11.2011 dhe zgjatë deri më 20.12.2011.

6. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozim-vendimit që kushtëzon qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për kryerjen e borxheve nga KRM “Uniteti”;

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se këtë çështje e kemi shqyrtuar edhe më herët. Pastaj tha se një vendim i tillë që aprovohet në kuvend, duhet të shkojë edhe në MAPL për t’u shqyrtuar bazueshmëria e tij në ligj. Mandej tha se nëse vazhdimisht pohohet se qytetari është mbi të gjitha, nuk duhet të bëhemi shkelës të të drejtave të qytetarëve, dhe në rastin konkret po i shantazhojmë qytetarët, duke i kushtëzuar ata për t’iu ofruar shërbime, prandaj është e nevojshme që të bëhet një analizë e përgjithshme. Gjithashtu, tha se ka fatura që janë të fryra, edhe të periudhave të mëhershme, kurse dihet që në procedura të përgjithshme njihet edhe afati i parashkrimit të kërkesave, prandaj nesër një vendim i tillë mund të keqpërdoret në dëm të qytetarëve, sepse shantazhohen obligimet kinse të fryra. Në vazhdim tha se në emër të Grupit parlamentar të AAK-së hezitojmë që ta votojmë një vendim të tillë, përderisa nuk e marrim vlerësimin e ligjshmërisë për vendimin në fjalë nga MAPL-ja, se vërtet një vendim i tillë nuk i cenon të drejtat e qytetarëve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se nuk dëshiron të besojë që një propozim-vendim i tillë nuk është i bazuar në ligj të procedohet në kuvend nga kryetari i komunës dhe drejtori për shërbime publike, por do të dëshironte që propozim-vendimi në fjalë të jetë i bazuar në ligj që t’i shërbejë interesit të përgjithshëm. Pastaj tha se është fakt pozita e rëndë e punëtorëve të kësaj kompanie, duke shtuar

se nëse qeveria lokale dëshiron ta përkrah këtë kompani, ka forma tjera, pa ardhur te kjo, prandaj pyeti çfarë po bën komuna për të krijuar investime në komunë dhe për t'u përmirësuar pozita e njerëzve, në mënyrë që t'i kryejnë obligimet, sa vende të punës po gjenerohen, dhe shtoi se 99.000 € i ka humbur komuna në konteste gjyqësore. Mandej tha se nëse ky propozim-vendim është i bazuar në ligj, nuk ka arsye që të kundërshtohet, pasi që është në interesin tonë.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se çdo institucion publik duhet t'i gjej mekanizmat e vet për mbledhjen e obligimeve, si dhe për kryerjen e obligimeve. Pastaj tha se edhe te rasti i regjistrimit të automjeteve, qendra e regjistrimit kërkon që të merret një vërtetim në komunë, edhe pse është e kundërligjshme, po aplikohet. Mandej tha se të gjithë jemi të pajtimit që të kemi një ambient të pastër, dhe gjithashtu dihet që gjendja e kësaj ndërmarrjeje është e keqe, kjo falë menaxhimit të dobët. Kurse lidhur me kërkesën e ndërmarrjes "Uniteti" për ndihmën që kërkon nga komuna, tha se deri më sot asnjëherë nuk kemi pas ndonjë raport të gjendjes financiare të ndërmarrjes "Uniteti". Gjithashtu sektori i faturimit te kjo ndërmarrje është mjaft neglizhent dhe rreth 35 % të bizneseve dhe të ekonomive familjare nuk faturohen fare, dhe shtoi se edhe nëse aprovohet vendimi në fjalë, nuk do të ketë rritje të inkasimit të të hyrave për këtë ndërmarrje, pasi që edhe te kushtëzimet që janë bërë në rastin e regjistrimit të automjeteve, çdo automjet është regjistruar, kurse afër 70 % të tyre që i kanë regjistruar automjetet kanë obligime në tatimin në pronë dhe në taksë. Prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të hetojë rastet e regjistrimit të automjeteve, lëshimit të vërtetimeve, në emër të asaj që i kanë përmbushur obligimet, kurse në realitet kanë borxhe me vite të tëra.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se paraprakisht duhet shikuar se sa është serioze kompania në fjalë, pasi që menaxhimi i kompanisë është i keq, dhe nga kjo situatë mund të nënkuptohet se po i ndihmojmë të keqes në rastin konkret.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, lidhur me atë se a duhet të kushtëzohen qytetarët me vërtetimet që duhet të pajisen me dokumente që duhet t'i marrin nga komuna, kurse komuna është e obliguar ligjërisht t'i pajisë me këto dokumente, tha se nuk kemi të drejtë, pasi që me këtë bëhet shkelje e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Mandej shtoi se kjo kompani duhet t'i padisë borxhlinjtë në gjyq dhe në këtë mënyrë i detyron qytetarët që përmes gjyqit të realizojnë obligimet që i kanë, dhe shtoi se kompania e cila e ka fituar tenderin në atë kohë, është dashtë të ketë parasysh se mund të ballafaqohet me këto rrethana që nuk janë të volitshme. Gjithashtu tha se është edhe diçka e rëndësishme që duhet të dihet se cilët qytetarë duhet të përfshihen në këto kushtëzime. Në vazhdim tha se anëtarët e kuvendit nuk bën të bien në grackën e obligimeve që nuk janë tonat, dhe shtoi se ne kërkojmë që qyteti të jetë i pastër, sepse kompania e ka fituar tenderin, dhe detyrë e komunës është që të përcjellë se a po i kryen kompania obligimet siç duhet.

Ragip Mikushnica, menaxher i njësisë operative të KRM-së "Uniteti" në Vushtrri- tha se kompania në fjalë ka bërë kërkesë të bazuar. Pastaj lidhur me atë se çka është në interesin e qytetarëve, tha se nëse është interesi vetëm me 30 % të pagesave në amvisëri, pyeti se a ia vlen që 70 % që nuk i përgjigjet obligimeve të mbrohet, dhe shtoi se ky 70 % do të vazhdojë të mos paguaj edhe vitet e ardhshme, përderisa të gjenden mekanizma që i detyrojnë të paguajnë. Në vazhdim lidhur me propozimin që kompania të padisë borxhlinjtë në gjykata, tha se dihet mirë se sa funksionojnë gjykatat, dhe njoftoi se në tre muajt e parë kompania ka shumë lëndë në gjykata dhe në ata tre muajt kanë sjell rezultate pozitive për kompaninë, por me kalimin e kohës, borxhlinjtë e kanë kontestuar borxhin në gjykatë dhe çështja ka kaluar në shkallë të dytë. Gjithashtu njoftoi se kompania që 3 vite nuk ka bërë asnjë padi, pasi që me paraqitjen e padive, kompania po krijon shpenzime, dhe shpenzimet gjyqësore nuk janë të vogla. Mandej lidhur me mbajtjen e pastërtisë në

Komunën e Vushtrrisë, tha se një ndër kushtet për pranim në Bashkimin Evropian është mbrojtja e ambientit. Kurse lidhur me menaxhimin, tha se për çdo ditë kompania i zbrazë kontejnerët, me të vetmin qëllim që të kemi një qytet sa më të pastër, dhe njoftoi se 32 tonë mbeturina shkojnë brenda një dite në deponinë regjionale në Mitrovicë, prandaj kostoja e shpenzimeve është shumë e madhe, dhe me 30 % inkasim, kompania nuk mund ta rrisë cilësinë më tepër se sa që e ka aktualisht, sepse për ta ngritur performancën, nevojiten shpenzime shtesë. Në vazhdim tha se kërkesat e fshatrave janë të mëdha, prandaj duhet bërë përpjekje që brenda tri viteve të futen tërë fshatrat nën menaxhim.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se nuk është kundër inkasimit të kompanisë, por dilema është se a është kjo metoda që do të duhej ta aplikoni për të mbledhur inkasimet, prandaj tha se kjo nuk është rruga më e mirë për të siguruar inkasimet. Gjithashtu tha se nëse aprovohet vendimi në fjalë, pastaj këtij vendimi duhet vlerësuar ligjshmërinë e tij në MAPL, dhe si i tillë do të hedhet poshtë, pasi që nuk ka bazë ligjore, dhe në këtë mënyrë nuk do t'i ndihmohej asgjë kompanisë në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se një ndër shqetësimet është edhe gjendja e rëndë e kompanisë në fjalë, e cila nuk ka mekanizëm të mjaftueshëm dhe mungesa e ekspertëve të mjaftueshëm, gjithashtu iu mungon edhe plani i veprimit, dhe shtoi se kur të hartohet plani i veprimit, duhet të hartohet në atë mënyrë që t'i përfshijë edhe të gjitha fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, në mënyrë që të menaxhohen mbeturinat në secilin cep të komunës tonë, e jo vetëm në qytet. Në vazhdim u pajtua me gjendjen e rëndë materiale të kompanisë, por shtoi se kompania nuk ka një menaxhim të mirë, sepse po të ishte menaxhimi i mirë, do të zbutej edhe gjendja materiale. Pastaj tha se asnjëherë asnjë raport nuk e kemi pas mbi të hyrat dhe të dalurat e kompanisë. Në vazhdim tha se i ka propozuar kompanisë në fjalë që të bëjë kontratë me secilën familje, dhe kompania të organizojë marrjen (mbledhjen) e mbeturinave nëpër shtëpi, sepse nëse mungojnë kontratat e tilla, kompania nuk mund t'i padisë në gjykatë. Gjithashtu paraqiti vërejtje që kompania nuk ka bërë padi qe tri vite në gjykatë. Në fund paraqiti këtë modalitet: Komuna e Vushtrrisë me kompaninë duhet ta bëjë një marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave, dhe në kuadër të kësaj marrëveshjeje të hyn edhe përkrahja e komunës për menaxhimin e borxheve (faturave). Në marrëveshje mund të përcaktohet edhe periudha kohore për inkasimin e borxheve në mënyrë retroaktive për periudhën njëvjeçare. Gjithashtu komuna duhet të përcaktojë edhe kushte në marrëveshje, dhe shtoi se për momentin komuna nuk po menaxhon mbeturinat edhe në viset rurale, dhe aty ku kompania i menaxhon mbeturinat, të hyjnë qytetarët në detyrimin për t'i paguar mbeturinat, por në momentin që kompania fillon menaxhimin e mbeturinave në një fshat, duhet t'ua dërgojë listën dhe t'i informojë që duhet të fillojnë të bëjnë pagesë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozimin e kryetarit të komunës, pasi që edhe në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë lejohet që të arrijmë marrëveshje, prandaj kërkoi nga kuvendi i komunës që ta autorizojë kryetarin e komunës që të nënshkruajë marrëveshje me kompaninë në fjalë.

Ragip Mikushnica, menaxher i njësisë operative të KRM-së "Uniteti" në Vushtrri- sqaroi se kushtëzimet vlejné vetëm për ata që hyjnë në menaxhim, e jo nëpër fshatra që nuk hyjnë në menaxhim.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar marrëveshjes në parim, tha se kompania ka për obligim t'i menaxhojë mbeturinat dhe higjienën sipas ligjit; duhet ta hartojë një plan të veprimit për menaxhimin e mbeturinave për tërë Komunën e Vushtrrisë; kompania duhet të lidhë kontrata me të gjitha ekonomitë familjare dhe bizneset ku i menaxhojnë dhe ku fillojnë t'i menaxhojnë mbeturinat, kurse komuna obligohet ta ndihmojë kompaninë në menaxhimin e të hyrave përmes kushtëzimit, në ato hapësira ku bëhet menaxhimi i mbeturinave.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozimit të paraqitur nga kryetari i komunës për marrëveshje, tha se propozimi ka arsyeshmëri të plotë, mirëpo propozim-vendimi i paraqitur në imperativ, pa detyrime të njëjës ose palës tjetër, prandaj është e nevojshme që të precizohen në letër të gjitha këto, duke filluar edhe prej afatit të aplikimit. Në fund tha se marrëveshja individuale e individit, pa miratimin dhe bekimin e kuvendit të komunës, nuk është marrëveshje valide, prandaj kërkoi që të hartohet marrëveshja dhe për seancën e radhës të ketë një propozim konkret.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- Grupi parlamentar i LDK-së pajtohet me propozimin e fundit, por duhet t'i shtohet që te kompanitë publike komuna është aksionare e aseteve, prandaj paraprakisht kërkoi raport të aseteve që i ka komuna aty, raport se si funksionon kompania, si bëhet shpërndarja e investimeve në nivel rajonal dhe sa participon me të hyra njësia operative e KRM-së "Uniteti" njësia në Vushtrri dhe sa participon në asete. Mandej tha se kompania nuk ka shfrytëzuar edhe mundësitë tjera, para se me kërkuar nga kuvendi që të merrë vendim të kundërligjshëm, dhe si mundësi tjetër përmendi që kompania ka mundur t'iu dërgoi subjekteve politike një informatë, që ato të apelojnë tek elektorati i tyre për t'i kryer obligimet ndaj kompanisë në fjalë, gjithashtu mundësia tjetër ka qenë përmes Bashkësisë Islame në Vushtrri.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet në parim vendimi në fjalë, por zbatimi i tij kushtëzohet që paraprakisht Komuna e Vushtrrisë të arrijë marrëveshje me njësinë operative të KRM-së "Uniteti" në Vushtrri për çështjet të cilat ndërlidhen me zbatimin e këtij vendimi.

b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar përgjigjeve që ka marrë, për pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar e KK-së, tha se në aspektin e përmbajtjes dhe esencës, disa çështje është dashtë dhe duhet të vërtetohen. Pastaj tha se e ka shifrën e fundit që e kanë disa obligues tatimor dhe nëse kjo shifër është 103.361 €, pyeti a është kjo shumë e përgjithshme, pasi që shtoi se dyshon që ka obligime (borxhe) edhe më tepër. Gjithashtu, tha se ka mundësi të nxirren borxhet edhe nga vitet paraprake. Mandej nga të dhënat e numrit të familjeve që marrin ndihmë sociale, tha se rreth 16 % të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë marrin ndihma sociale, prandaj kërkoi që kuvendi i komunës ta trajtojë këtë çështje në mënyrën më serioze dhe këto familje të përkrahen qoftë prej buxhetit, apo donacioneve, ose formave të tjera. Kurse lidhur me keqpërdorimin ndaj qytetarëve të aseteve publike, shtoi se edhe Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që masa (dënime) kolektive nuk ka për asnjë popull, e lëre më për obligimet tjera ndaj ndërmarrjeve publike, dhe përmendi problemin e çkyçjeve kolektive të energjisë elektrike, dhe tha se ka raste kur 20 familje nuk kanë përmbushur obligimet, kurse janë 300 apo 500 familje që i kanë kryer obligimet, dhe iu ndërprehet rryma për shkak të tyre, prandaj kjo është lojë dhe keqpërdorim i pasurisë publike në dëm të qytetarëve të komunës, prandaj kërkoi që kuvendi të adresojë një vërejtje dhe kërkesë nga Qeveria e Kosovës, por edhe nga kuvendi komunal që të merren masat që të mos ketë ndërprerje kolektive të energjisë elektrike.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se pajtohet që nuk mund të jetë borxhi vetëm 103.361 € nga taksat komunale. Pastaj propozoi që të gjithë borxhlinjtë e taksës në firmë dhe në tatim në pronë të publikohen në ueb-faqen e Komunës së Vushtrrisë. Në vazhdim tha se nga të hollat e inkasuara nga taksat e qytetarëve në këtë vit janë asfaltuar afër 70 kilometra, afër 6 kilometra janë shtruar rrugë në kubëza. Kurse lidhur me propozimin që familjet me asistencë sociale të ndihmohen

akoma, tha se pajtohet për t'iu ndihmuar, nëse do të kishte mundësi të tillë, dhe njëkohësisht shprehu dyshimin se të gjitha familjet që marrin asistencë sociale janë raste që e meritojnë asistencën e tillë, pasi që ka familje që për beneficione të tjera bën çmos për të hyrë në asistencë sociale, dhe njoftoi se Komuna e Vushtrisë është ndër komunat që më së shumti jep subvencione për familjet skamnore, dhe që 2 vite komuna ka ndarë mjete për furnizim me material ndërtimor për familjet pa strehë. Mandej tha se nuk është përpiluar mirë Rregullorja për menaxhimin e subvencioneve, pasi që shumë shpejt janë shpenzuar të hollat, dhe kanë kaluar dy muaj që nuk ka mjete në subvencione, prandaj propozoi që në të ardhmen të caktohen disa kritere të veçanta se si të menaxhohen subvencionet. Ndërsa lidhur me ndërprerjen e energjisë elektrike në mënyrë kolektive, tha se si kryetar i komunës ka bërë presion të vazhdueshëm për të ndërprerë këtë praktikë të KEK-ut për ndërprerje kolektive të energjisë elektrike, pasi që është e kundërligjshme dhe shkelje e të drejtave të njeriut, mirëpo njëkohësisht apeloi tek qytetarët e Komunës së Vushtrisë që ta paguajnë energjinë elektrike. Gjithashtu tha se KEK-u në Mitrovicë dhe Vushtrri nuk janë transparent, pasi që nuk tregojnë saktë sa paguhen borxhet.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi informatë për eliminimin e barnave në Komunën e Vushtrisë, pasi që është brengosëse që në ditët e fundit janë eliminuar 19 tonë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se në seancën e kaluar ka kërkuar informatë me regjistër të kompletuar të projekteve prioritare për vitin 2012, por në regjistrin që e ka marrë mungon projekti për rrugën në lagjet "Ferizi, Islami, Peci, Hajdari" në fshatin Bruznik, prandaj për seancën e ardhshme lidhur me rrugën në fjalë, kërkoi informatë se a ka hyrë në projektet për vitin 2012.

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi informatë nga Drejtoria për Arsim lidhur me të gjithë nxënësit e tri shkollave të mesme, të cilët kanë diplomuar, pasi që është shpallur rezultati nga Ministria e Arsimit, dhe numrin e pikëve që e kanë pasur nxënësit sipas rezultatit të shpallur zyrtarisht.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtje që afër Shtëpisë së Kulturës në Vushtrri ka filluar të ndërtohet një objekt, prandaj pyeti se a ka uzurpim të pronës shoqërore, pasi që në atë pjesë ka një dalje tjetër të Shtëpisë së Kulturës.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së pyeti se si është zgjedhur kontesti për rrugën që lidh lagjen "Mustafa" me rrugën regjionale Bukosh – Druar, pasi që ka qenë temë e debatit edhe në kuvend, dhe kuvendi ka marrë vendim që të formohet një komision për pamundësinë e shfrytëzimit të rrugës që lidh lagjen "Mustafa" të fshatit Reznik me rrugën regjionale Bukosh – Druar, dhe pyeti pse kjo rrugë nuk mund të shfrytëzohet nga fshatarët dhe pse nuk është në projekte për rregullim, pasi që lidh një lagje të tërë me rrugën regjionale.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi që t'iu dorëzohet një listë e vërtetimeve të lëshuara nga komuna për kryerjen e obligimeve për tatim në pronë dhe taksë në firmë për tre muajt e fundit. Pastaj kërkoi raport për gjendjen sociale në komunë. Mandej kërkoi një listë për lëshimin e lejeve ndërtimore për vitin 2011. Në fund kërkoi një listë të menaxhmentit komunal, duke filluar nga drejtorët e drejtorive deri te shefat e sektorëve se sa i kanë kryer të gjitha obligimet ndaj komunës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- pyeti kryetarin e komunës se a janë marrë masat e nevojshme që gjatë stinës së dimrit, nëse ka reshje të mëdha, të jemi sigurt të mbrojtur nga vërshimet, dhe për këtë kërkoi informatë. Gjithashtu pyeti kryetarin a ka filluar ndërtimi i rrugës në fshatin Dumnicë e Llugës, pjesa mbi varreza deri tek familjet "Balaj" e që vazhdon deri në Zagori, dhe shtoi se aty kanë filluar punimet, por aty kishin marr material guror që është i butë dhe i njëjti nuk është rezistues ndaj lagështisë dhe pjesa e zallit të shtrirë ishte një shtresë jashtëzakonisht e hollë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me pyetjet rreth marrjes së masave ndaj vërshimeve, tha se në parim komuna i ndërmerr masat ndaj vërshimeve përmes projekteve, dhe shtoi se vitin e kaluar ka filluar realizimi i një projekti për sanimin e “bankinës” në Pestovë, por njëkohësisht njoftoi se rregullimi i bankinave nuk është obligim i komunës, por është obligim i kompanisë Ibër-Lepenc. Kurse sa i përket punimeve për ndërtimin e rrugës në fshatin Dumnicë, tha se punimet përcillen përmes kompanisë që është e kontraktuar për përcjelljen e punimeve, dhe pasi që të bëhet kontrollimi teknik konstatohet se nuk është bërë shtrimi cilësor, përgjegjësinë e mbanë kompania që e bën mbikëqyrjen, pastaj edhe inxhinierët e komunës, dhe njoftoi se asfaltimi ka përfunduar deri aty ku ka qenë e paraparë. Kurse lidhur me pyetjen rreth kontestit në rrugën që lidh lagjen “Mustafa”, tha se ka bërë përpjekje maksimale për të arritur një marrëveshje me ta, por mosmarrëveshjet mes tyre janë të mëdha. Ndërsa, lidhur me vërejtjen për punimet afër Shtëpisë së Kulturës, tha se nuk kanë leje për ndërtim, mirëpo premtoi se do ta hulumtojë se a është cenuar prona publike.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- pyeti kryetarin e komunës pse shumica e drejtorëve të drejtorive e lëshojnë sallën e kuvendit, akoma pa përfunduar punimet e mbledhjes së KK-së.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Lektore:
Vlora Krasniqi